



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 27.07.20 Ref.: 1089/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC) mori:

**V E N D I M**

- I. Nuk riakreditohet Kolegji “Universi” në nivel institucional.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegjit Universi për vitin akademik 2020 – 2021 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**Arsyetimi**

I. Kolegji “Universi” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional. AKA ka organizuar vlerësimin me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin “Universi”, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional. Vlerësimi për riakreditim institucional është realizuar me 28.05.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Yelena Istileulova, Elene Jibladze dhe Delia Gologan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit “Universi”. Raporti i ekipit të ekspertëve të akreditimit për vlerësim institucional të Kolegjit Universi është trajtuar në këtë mbledhje të KSHC-së dhe i njëjti është refuzuar për shkak se KSHC ka konstatuar se ai bie ndesh me Manualin për Akreditim i cili përcakton se “niveli i përmbushjes së standardeve që përsëritet më shpesh në kapitujt e standardeve përcakton nivelin e përgjithshëm të përmbushjes së standardeve”. Mbi këtë bazë raporti është kthyer tek ekipi i ekspertëve të cilët pastaj kanë hartuar rekomandimin final në përputhje me kriteret e përcaktuara në manualin për akreditim.

Me datë 6.07.2020, në formë elektronike, ashtu siç është e përcaktuar në rregulloren e KShC-së, neni 12, pika 8, KShC vendosi për refuzimin e akreditimit të Kolegjit Universi mbi bazën e rekomandimit final të ekspertëve të akreditimit.

dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vlerësimit, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Kolegji "Universi" përmbushë vetëm pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji "Universi" i plotëson substancialisht pesë (5) (Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Burimet dhe hapësirat; Bashkëpunimi institucional), kurse pjesërisht plotëson gjashtë (6) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit; Menaxhimi i cilësisë; Mësimdhënia dhe të nxënit; Hulumtimi)

Sa i përket kapitullit "Misioni publik dhe objektivat institucionale", ekspertët e akreditimit kanë potencuar se Kolegji Universi në raportin e vet-vlerësimit ka paraqitur gjashtë iniciativa strategjike apo objektiva strategjike, përdërisa në dokumentin Plani Strategjik 2016-2021 përfshinë objektiva specifike të dara në pesë fusha. Ekipi i ekspertëve ka konstatuar se kjo gjë shkakton pasiguri dhe rekomandon evitimin e kësaj mungese të konsistencës. Po ashtu, në kuadër të këtij kapitulli të standardeve ekspertët e akreditimit konstatojnë se është e tepruar posedimi i dy misioneve.

Sa i përket kapitullit të standardeve "Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi", ekspertët kanë konstatuar se ky kapitull i standardeve përmbushet vetëm pjesërisht nga Kolegji Universi, duke vënë theksin tek mospërputhja në mes të planifikimit financiar dhe strategjive të institucionit. Pos kësaj ekipi i ekspertëve ka gjetur se nuk ekzistojnë raporte mbi zbatimin e planeve strategjike, dhe kjo e bënë të pamundur vlerësimin e kapaciteteve të kolegjit Universi për arritjen e objektivave strategjike.

Sa i përket kapitullit të standardeve "Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit", në raportin e vlerësimit ekspertët kanë deklaruar se Kolegji Universi ka të zhvilluar planin e biznesit për periudhën 2019-2022. Të hyrat e paraqitura në këtë plan për vitin 2019 tregojnë një shumë më të vogël se sa shpenzimet. Hapësira në mes të të hyrave dhe shpenzimeve vazhdon dhe rritet nga viti në vit deri në vitin 2022. Sipas vlerësimit të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, Kolegji Universi e plotëson vetëm pjesërisht këtë kapitull të standardeve.

Sa i përket kapitullit të standardeve "Menaxhimi i cilësisë", ekipi i ekspertëve të akreditimit ka vlerësuar se Kolegji Universi i plotëson pjesërisht standardet e përfshira në këtë kapitull. Në mesin e gjetjeve të

paraqitura në raportin e vlerësimit, ekspertët kanë përmendur edhe mungesën e dedikimit të burimeve të mjaftueshme njerëzore për mbulimin e aktiviteteve dhe funksioneve që kanë të bëjnë me menaxhimin e cilësisë. Pos kësaj, ekspertët kanë konstatuar se sa i përket sigurimit të cilësisë Kolegji Universi i kushton shumë rëndësi komponentit të mësimdhënies dhe të nxëniet, po len anash komponentin e hulumtimit dhe kontributit në komunitet.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Mësimdhënia dhe të nxëniet”, ekipi i ekspertëve ka pohuar se Kolegji Universi ka rregulloren për studimet bachelor dhe rregulloren për studimet master. Megjithatë ekspertët rekomandojnë që institucioni të krijojë mekanizma për monitorimin e zbatimit të këtyre rregulloreve. Për më tepër ekspertët e akreditimit kanë thekuar se, megjithëse përmirësimi i mësimdhënies dhe të nxëniet është një nga prioritetet kryesore të Kolegjit, në RVV nuk është dhënë një listë me mundësi trajnimi për stafin akademik e as nuk është ofruar ndonjë shpjegim se si bëhet identifikimi i nevojave për trajnim.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Hulumtimi”, ekspertët ndërkombëtar të akreditimit kanë konstatuar se Kolegji Universi nuk ka një plan për zhvillim të komponentës së hulumtimit. Ekipi i ekspertëve gjithashtu ka vërejtur se në uebfaqen e institucionit tek pjesa e hulumtimeve është përsëritur disa here portfolio e njëjtë, p.sh. ekspertët kanë përmendur në raportin e vlerësimit 3 raste ku për profesorë është prezantuar dosja e njëjtë e punimeve shkencore.

Prandaj, duke u bazuar në gjetjet e ekspertëve të akreditimit si dhe në rekomandimin final të tyre për mos akreditimin e Kolegjit Universi, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit “Universi”
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.